

UMASS MEMORIAL HEALTH CARE
FINANCIAL ASSISTANCE PROGRAM
POLICY SUMMARY (Albanian)

Pamje e përgjithshme

Është politikë e "UMass Memorial Health Care" ("UMMHC") që të ofrojë kujdes shëndetësor falas ose me zbritje për pacientët që shfaqin nevojë financiare për shërbime kujdesi mjekësor të nevojshëm, urgjente ose emergjente në të gjitha vendndodhjet e spitaleve të mëposhtme: "UMass Memorial Medical Center", "UMass Memorial - Clinton Hospital", "UMass Memorial - HealthAlliance Hospital" dhe "UMass Memorial - Marlborough Hospital". "UMMHC" ofron disa mundësi për të ulur shpenzimet e pacientëve që shfaqin nevojë financiare, duke përfshirë ofrimin e ndihmës për regjistrimin e pacientëve në programin e Health Safety Net (Rrjetit të Sigurisë Shëndetësore) dhe në programe të tjera sigurimi të sponsorizuara nga Federata e Masaçusetsit, zbritje kur beni pagesen menjehere, planet e pagesës dhe Programin e asistencës financiare të "UMMHC" të përshkruar më poshtë. Gjithashtu, grupi mjekësor i "UMass Memorial" ofron një program të veçantë asistence financiare të bazuar në një tarifë të ndryshueshme bazë.

Mënyra e kualifikimit

Asistenca financiare disponohet për pacientët dhe anëtarët e familjes me të ardhura familjare më të ulëta se 600% të Udhëzuesit të nivelit federal të varfërisë. Nëse kualifikoheni, nuk do të faturoheni më shumë se faturimi i përgjithshëm që u bëhet pacientëve të mbuluar me sigurim.

Për t'u përcaktuar si person me të drejtë kualifikimi, ju duhet të:

- aplikoni për çdo program asistence mjekësore, shtetëror apo qeveritar, për të cilat mund të kualifikoheni.
- plotësoni, nënshkruani dhe shkruani datën në aplikimin për Programin e asistencës financiare.
- jepni verifikim për të gjitha të ardhurat familjare.
- ktheni aplikimin e plotësuar pranë Departamentit të Këshillimit Financiar (Financial Counseling Department).

Mënyra e aplikimit

Kontaktimi me Departamentin e Këshillimit Financiar të Pacientit për të kërkuar falas një kopje të politikës së Programit të asistencës financiare, aplikimin për Programin e asistencës financiare dhe udhëzimet për mënyrën e plotësimit të tij. Kjo kërkesë mund të bëhet me telefon, personalisht ose me email.

Informacioni i kontaktit i Departamentit të Këshillimit Financiar të Pacientit të "UMass Memorial":

- Telefon: 508-334-9300
- Email: needinsurance@umassmemorial.org
- Adresa: 306 Belmont Street, Worcester, MA 01604

Kjo përmbledhje e politikës së Programit të asistencës financiare të "UMMHC", aplikimi për Programin e asistencës financiare dhe udhëzimet për mënyrën e plotësimit të tij disponohen në anglisht, spanjisht, portugalisht, vietnamsht dhe arabisht në faqen e internetit të "UMass Memorial Health Care".

Shkoni te www.umassmemorialhealthcare.org > Patient and Visitors (Pacientët dhe vizitorët) > Financial Counseling (Këshillimi financiar) dhe klikoni në faqen e spitalit. Do t'ju shfaqen formularët e renditur.